

Në përgjigje të kërkesës drejtuar Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, adresuar nëpërmjet e-mailit, konkretisht referuar pyetjes: “A ka një mundësi nga ana e shtetit për t’i lidhur/punësuar një person disa orë paradite përgjatë pesëditëve pune të javës për t’i dhënë shërbimet bazë siç janë ilacet dhe ushqimi , ju informojmë se:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ushtron veprimtarinë e tij në zbatim dhe nëpërputhje të ligjit nr. 10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në nenin 10 të këtij ligji parashikohen se sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;
- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;
- barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

Për sa më sipër, Fondi financon dhënës shërbimi të kontraktuar për shërbime shëndetësore dhe barnae produkte mjekësore, të përfshira në paketën e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore, të dhëna në përputhje me termat dhe kushtet e kontratave të miratuara me Vendim të Këshillit Administrativ dhe të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.